



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Territorit

Nr. 2351 prot.

Pukë më 23/12 /2021

PROJEKT-VENDIM

Nr. 02, Datë 23/12 /2021.

PËR
PROCEDURAT E PRIORITETEVE PËR INVESTIME E SHËRBIME PËR VITIN 2022

Në zbatim të nenit 3, nenit 4, nenit 23, nenit 27, nenit 54, nenit 55, të ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisje Vendore" (i ndryshuar); Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"; Ligjit nr.10296/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", (i ndryshuar); Ligji nr.9936/2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar); Ligjit nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2021"; Udhëzim nr. 30/2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"; Udhëzimin nr.9/2018 "Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit" dhe parashikimeve për investime në PPV-në për Bashkinë Pukë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim kërkesën:

VENDOSI:

Të miratojë listën e prioriteteve për investime e shërbime në Bashkinë Pukë për vitin 2022 si me poshtë vijon:

1. Ndriçimi i rrugës Kukaj, Bashkia Pukë
2. Ndërtim shëtitorja Kukaj-Liqeni, Bashkia Pukë
3. Ndërtimi i rrugës pas Bankës, Bashkia Pukë
4. Ndërtim shëtitorja para Kishës "Gjon Pagëzori", Bashkia Pukë
5. Rikonstruksion pjesor i objektit të Njësisë Administrative Qelëz
6. Riparim i çatisë në shkollën 9 vjeçare Bushat, Njësia Administrative "Qelëz"
7. Riparime/ndërhyrje në kanalën vaditës fshati Dedaj, Njësia Administrative "Qelëz"
8. Ndërtim rezervuar uji në fshatin Midhë, Njësia Administrative "Qelëz"
9. Ndërtim ure në fshatin Katund, Lagjja Balaj-Kovacaj, Njësia Administrative "Qelëz"

10. Riparim i urës këmbësore në lagjën Breg, (poshtë urës së madhe), Njësia Administrative “Qelëz”
11. Ndërtim ura auto Kabash, Njësia Administrative “Rrape”
12. Ndërtim ura auto Fshati Bicaj (ish rep. usht.), Njësia Administrative “Rrape”
13. Ndërtim ujësjellësi me shpim shkolla Breg, Njësia Administrative “Rrape”
14. Shtrim me asfalt rruga + oborri i shkollës Rrape, Njësia Administrative “Rrape”
15. Ndriçim Rrape (4 shtylla), Njësia Administrative “Rrape”
16. Zgjatim i rrugës së fshatit Vozë për lagjen Gjokaj, Njësia Administrative “Gjegjan”
17. Riparim të pjesshëm ura këmbësore (Shkozë, Kalivare, Dom), Njësia Administrative “Gjegjan”
18. Mbjellje e pemëve dekorative të llojit blin për pedonalen dhe pranë institucioneve, Njësia Administrative “Gjegjan”
19. Ndriçim në qendrat e fshatrave Gojan i Vogël, Gojan i Madh dhe Shkozë, Njësia Administrative “Gjegjan”
20. Rikonstruksion i pallatit tre katësh në qendër të Lufit, Njësia Administrative “Luf-Qerret”
21. Asfaltim i rrugës për në fshatin Pla, Njësia Administrative “Luf-Qerret”
22. Ndërtim urë auto fshati Pla, Njësia Administrative “Luf-Qerret”
23. Riparim i urës këmbësore së fshatit Dush, Njësia Administrative “Luf-Qerret”
24. Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit, fshati Qerret, Njësia Administrative “Luf-Qerret”
25. Ndriçim para Njesisë (4 shtylla), Njësia Administrative “Luf-Qerret”
26. Përmirësimi i rrjetit infrastrukturor, Bashkia Pukë

Ngarkohet Administrata e Bashkisë Pukë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit nr.139/2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore”.

Hartuesi

Drejtori i Urbanistikës

Alda MEMA

Juristi

Igli TRUPJA

KRYETARI

GJON GJONAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA PUKË

RELACION

Pukë, më 23.12.2021

№. 2351/1

**PËR
PROÇEDURAT E PRIORITETEVE PËR INVESTIME E SHËRBIME PËR VITIN
2022**

Në kuadër të hartimit të objektivave për Rivitalizimin Urban dhe atë Rural Bashkia Pukë ka hartuar për vitin 2022 listën e prioriteteve për investime, ku janë të përfshira shërbime, sistemime dhe ndërtime të objekteve të ndryshme.

Në qytetin e Pukës me zhvillimet e reja po aplikohen projekte të ndryshme rikualifikuese dhe rivitalizuese të tij, të cilat po krijojnë perspektiva të reja zhvillimi ekonomik dhe social për qytetin dhe banorët e zonës.

Duke u mbështetur në gjendjen fizike të infrastrukturës ekzistuese, në plotësimin e nevojave në rritje për investime në infrastrukturë në territorin e Bashkisë Pukë, si dhe për të krijuar një mjedis sa më funksional, estetik dhe bashkëkohor brenda këtij territori, janë parashikuar rikonstruksionet e rrugëve, urave, rehabilitimi i hapësirave publike, të cilat do të kenë impakt të drejtëpërdrejtë të nevojat e qytetarëve.

Gjithashtu një përqindje të konsiderueshme të prioriteteve e zë vazhdimësia si fazë e dytë e investimeve të përfunduara në vitin 2021, siç është ndriçimi i rrugës Kukaj, investim pasues nga investimi i përfunduar i asfaltimit të saj apo edhe propozimi për ndërtimin e urës auto Kabash si vazhdimësi e hapjes së rrugës së re. Me qëllim orientimin e të rinjve dhe të disa grupmoshave, drejt aktiviteteve dhe disiplinave të ndryshme lidhur me turizmin, prioritet për bashkinë ka përmirësimi dhe krijimi i ambienteve të ndryshme, si rehabilitimi i shëtitorës Kukaj-Liqeni si dhe shëtitorja para Kishës.

Lista për investimet përmban objekte të ndryshme, në të cilat është e nevojshme ndërhyrja për të ofruar një shërbim më të mirë komunitetit.

Për sa më sipër kërkojmë nga ana juaj miratimin e projekt-vendimit për procedurat e prioriteteve për investime e shërbime për vitin 2022.

JU FALEMINDERIT!

Drejtor i Urbanistikës dhe
Planifikimit të Territorit
ALDA MEMA

KRYETARI I BASHKISË

GJON GJONAJ

